



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Nr. 1970 / Prot.
17

Divjakë, më 18.03. 2026

PROJEKT – VENDIM

Nr. 32, datë 18.03. 2026

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 89, DATË 29.12.2025, “PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE TË BASHKISË DIVJAKË, INSTITUCIONEVE NË VARËSI, TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE DHE TË FUNKSIONEVE TË DELEGUARA PËR VITIN 2026”,

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54, gërma “dh”, të ligjit nr. nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 75, datë 06.02.2026, “Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë Prefektit të Qarkut”, i propozohet Këshillit të Bashkisë Divjakë që në mbledhjen e datës 30.03.2026,

Të miratojë:

1. Ndryshimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Divjakë, në Administratën Qendër dhe Njësitë Administrative, si rrjedhojë e ristrukturimit të nëpunësve të gjendjes civile duke e ulur numrin total nga **488** punonjës në **486** punonjës.



2. Si rrjedhojë e këtij ndryshimi nga 5 (pesë) nëpunës të gjendjes civile (1 (një) nëpunës në Administratën Qendër dhe 4 (katër) nëpunës në Njësitë Administrative), do të mbeten 3 (tre) nëpunës.
3. Nga shkurtimi i 4 (katër) pozicioneve të nëpunësve të gjendjes civile në Njësitë Administrative Tërbuf, Gradishtë, Remas dhe Grabian, 2 (dy) prej këtyre pozicioneve do të transferohen dhe do t'i shtohen numrit të punonjësve në Administratën Qendër, ku do të funksionojë një zyrë e vetme e shërbimit të gjendjes civile e përbërë nga (1 (një) përgjegjës dhe 2 (dy) specialistë). Efektet e këtij riorganizimi do të fillojnë nga data **30 mars 2026**, datë në të cilën shërbimi i gjendjes civile do të funksionojë sipas përbërjes së re organizative.
4. Si rezultat i këtij rishikimi, numri i përgjithshëm i punonjësve të Administratës Qendër dhe të Njësisë Administrative do të ndryshojë si më poshtë vijon:
 - Administrata Qendër e Bashkisë: nga **139** punonjës në **141** punonjës (shtohen 2 (dy) specialist të gjendjes civile);
 - Njësia Administrative Tërbuf: nga **35** punonjës në **34** punonjës (shkurtohet pozicioni i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile);
 - Njësia Administrative Gradishtë: nga **29** punonjës në **28** punonjës (shkurtohet pozicioni i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile);
 - Njësia Administrative Remas: nga **25** punonjës në **24** punonjës (shkurtohet pozicioni i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile);
 - Njësia Administrative Grabian: nga **21** punonjës në **20** punonjës (shkurtohet pozicioni i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile).

**Drejtorja e Burimeve Njerëzore
dhe Shërbimeve të Brendshme**
Atalanta Simaku
Drejtorja e Financës dhe Buxhetit
Xheladin Brahkola
**Drejtorja Juridike, Prokurimeve Publike
dhe Menaxhimit Aseteve**
Andi Bullari

KRYETARI
JOSIF GORREA
NË MUNGESË DHE ME URDHËR
N/KRYETARI
SILVANA KEKO

